

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6673
E shtunë, 6 gusht 2022
çmimi 0.40

Policia zhvillon aktivitete shtesë për ngritjen e sigurisë në trafik | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS THEKSOJNË SE TEMA PËR ASOCIACIONIN E KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE PRITET TË DISKUTOHET GJATË KËTIJ MUAJI NË BRUKSEL | FAQE 4-5

ESCOBAR: ASOCIACIONI NUK DUHET TË JETË SHTET BRENDA SHTETIT



I dërguari i Posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka theksuar se krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nuk duhet të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe të krijojë "shtet brenda shtetit". "Ne kemi qenë të qartë se palët janë pajtuar më herët për Asociacionin, prandaj duhet të diskutohet", ka deklaruar ai, duke besuar se kjo temë do të diskutohet gjatë këtij muaji në Bruksel

ÇFARË NË TË VËRTETË BËN LISTA SERBE NË INSTITUCIONET E KOSOVËS?

Zyrtarë të Listës Serbe shpeshherë thonë në publik se kjo parti politike është përfaqësuesja e vetme ligjore dhe legjitime e serbëve në institucionet e Kosovës, por zëri i tyre pothuajse asnjëherë nuk dëgjohet në Kuvendin apo Qeverinë e Kosovës | FAQE 5



PRISHTINA NËN TINGUJT E YLLIT BOTËROR

 | FAQE 3

Mbrëmjen e 4 gushtit mijëra adhurues të muzikës janë mbledhur në Parkun Nacional të Gërmisë për ta shijuar performancën e Dua Lipës dhe të artistëve të ndryshëm

AKTUALE



PLAGJIATURA NË UP, NAGAVCI: URGJENTISHT DUHET TË BËJMË NDRYSHIME | F. 6

BIK-u I DREJTOHET KURTIT, KËRKON QË TË LEJOHET BARTJA E SHAMISË NË SHKOLLA | F. 7

1 266 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË | F. 2


EKONOMI



AZEMI: PUNËTORËT E SEKTORIT PRIVAT PO DISKRIMINOHEN | F. 8

PUBLIKOHET LISTA E VENDEVE MË TË PASURA NË BOTË, KOSOVA NË POZITËN E 105-të | F. 8

SPORT



BERISHA ARSYETOHET PËR FOTON ME LIDERIN ÇEÇEN: NUK JAM POLITIKAN | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Blinken: Stërvitjet ushtarake të Kinës pranë Tajvanit janë të pajustificueshme

UASHINGTON, 5 GUSHT - Sekretari amerikan i shtetit, Antony Blinken, tha këtë të premte se lëshimi i raketave nga Kina gjatë stërvitjeve ushtarake rreth Tajvanit ishte një përshkallëzim i pajustificuar, pasi Pekini tha se do të vendoste sanksione ndaj kryetares së Dhomës së Përfaqësuesve të ShBA-së, Nancy Pelosi, mbi vizitën e saj në ishull.

Gjatë një takimi me Shoqatën e Kombeve të Azisë Juglindore në Kamboxhia, Blinken u tha gazetarëve se vizita e Pelosit ishte paqësore dhe nuk përfaqësonte një ndryshim në politikën amerikane ndaj Tajvanit, duke akuzuar Kinën se po e përdorte atë si një "pretekst për ta rritur aktivitetin e saj ushtarak në dhe rreth ngushticës së Tajvanit".

Ai tha se situata kishte çuar në një "komunikim me tone të larta" gjatë takimeve të Samitit të Azisë Lindore në Phnom Penh, gjatë së cilave ai dhe ministri i jashtëm kinez Wang Yi morën pjesë së bashku me vendet e ASEAN-it. "I ripërsërita

pikat që ua bëmë të ditura publikisht dhe drejtpërdrejt homologëve kinezë ditët e fundit, për faktin se ata nuk duhet ta përdorin vizitën si pretekst për luftë, përshkallëzim, për veprime provokuese, dhe se nuk ka asnjë justifikim të mundshëm për atë që kanë bërë dhe i bëjmë thirrje që të ndërpresin këto veprime", tha ai.

Më herët të premten, Ministria e Jashtme e Kinës dënoi Pelosin për ato që i përshkroi si "veprimet e saj keqdashëse dhe provokuese", duke thënë se udhëtimi i saj në Tajvan përbënte "ndërhyrje serioze në punët e brendshme të Kinës". "Në përgjigje të veprimeve provokuese të kryetares së Dhomës së Përfaqësuesve të ShBA-së, Kina ka vendosur të vendosë sanksione ndaj Pelosit dhe familjes së saj", thuhej në deklaratë.

Pelosi tha se vizita e saj në Tajvan nuk kishte për qëllim ndryshimin e status quo-së për ishullin, por për të ruajtur paqen në ngushticën e Tajvanit, që



ndan Tajvanin dhe Kinën kontinentale. Ajo vlerësoi demokracinë dhe suksesin e Tajvanit në teknologji dhe biznes, ndërsa kritikoi Kinën mbi shkeljet e marrëveshjeve tregtare dhe mbi problemet e të drejtave

të njeriut, përfshi dhe trajtimin e pakicës myslimane të ujgurëve. Si kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve, udhëtimi i Pelosit ka rritur tensionet mes ShBA-së dhe Kinës. Kryetari i fundit i Dhomës së Përfaqësuesve të

ShBA-së që vizitoi Tajvanin ishte Newt Gingrich në vitin 1997. Kina dhe Tajvani, të cilat u ndanë pas një lufte civile në vitin 1948, nuk kanë marrëdhënie zyrtare diplomatike por gëzojnë lidhje tregtare dhe ekonomike.

ShBA-ja shpall gjendjen e emergjencës shëndetësore për shkak të lisë së majmunëve

Uashington, 5 gusht - Qeveria amerikane shpalli gjendjen e emergjencës shëndetësore për shkak të rritjes së numrit të të infektuarve me linë e majmunëve. Sipas zyrtarëve shëndetësorë rastet kanë arritur në 6 600 në ShBA në dy muajt e fundit. Sekretari i shërbimeve shëndetësore, Xavier Becerra, deklaroi më 4 gusht se ky vendim pritet që të bëjë të mundur lëvizimin e fondeve shtesë dhe të sigurojë mjetet e nevojshme për të luftuar sëmundjen. Becerra deklaroi se Shtetet e



Bashkuara "janë të gatshme ta çojnë në një nivel tjetër kundërpërgjigjen ndaj virusit dhe i bëjnë thirrje popullit amerikan që ta marrë seriozisht linë e majmunëve". Sipas të dhënave të publikuara më 4 gusht, numri i rasteve ka arritur në 6 600 në ShBA dhe shumica e tyre janë regjistruar në meshkuj që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj të tjerë. Ndryshe nga periudha kur Covid-19 u shfaq në Kinë në fund të vitit 2019, për linë e majmunëve ekzistojnë vaksina dhe

trajtime të disponueshme. Vendimi i qeverisë amerikane vjen dy javë pasi Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e shpalli linë e majmunëve "një emergjencë globale të shëndetit publik", niveli më i lartë i alarmit. OBSH-ja tha më 23 korrik se lija e majmunëve, e cila ka ekzistuar në disa rajone të Afrikës për dekada, është përhapur me shpejtësi përreth globit që nga muaji maj, duke prekur mijëra persona në më shumë se 70 shtete.

Ish-komisari i policisë që vrau 7-vjeçaren në Himarë akuzohet për "vrasje me dashje"

TRANË, 5 GUSHT - Gjykata e Vlorës dha masën e sigurisë në burg për ish-komisarin e policisë Arjan Tase pasi prokuroria e Vlorës ngriti akuzën e "vrasjes së kryer në formën e dashjes indirekte" të 7-vjeçares Jonada Avdia. Gjyqtarja Viola Canaj caktoi masën pas një procesi gjyqësor që zgjati më tepër se një orë në Gjykatën e Vlorës. Sipas burimeve Tase u shpreh i penduar në gjykatë duke u shprehur ngushëllimet familjarëve dhe duke i kërkuar falje policisë së shtetit. Më 2 gusht Arjan Tase, shefi i rendit



në policinë e Elbasanit, tani i përjashtuar nga Polica e Shtetit, drejtonte një skaf në plazhin e Potamit në Himarë, i cili goditi për vdekje brenda perimetrit të sigurisë 7-vjeçaren Jonada Avdia. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore e kishte referuar ngjarjen si "vrasje nga pakujdesia", por sipas prokurorisë së Vlorës ndaj tij rëndon akuzat e "vrasjes së kryer në formën e dashjes indirekte". Sipas Prokurorisë së Vlorës "drejtuesi i mjetit lundruar rezultoi se kishte patentë dhe ishte në dijeni të rrezikut që u sillte qytetarëve kur hyri në perimetritin

e sigurisë së plazhit". Sipas Kodit Penal shqiptar "vrasja e kryer me dashje" dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Të enjten në mbrëmje qindra qytetarë dolën në protestë në Tiranë para Ministrisë së Brendshme, për të kërkuar drejtësi për Jonadën. Protestuesit kërkuar që kryeministrit Edi Rama të shkarkojë nga detyra ministrin e Brendshëm Bledi Çuçi, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Gledis Nano dhe ministrin e Turizmit, Mirela Kumbaro.



Prishtina nën tingujt e yllit botëror

Mbrëmjen e 4 gushtit mijëra adhurues të muzikës janë mbledhur në Parkun Nacional të Gërmisë për ta shijuar performancën e Dua Lipës dhe të artistëve të ndryshëm



PRISHTINË, 5 GUSHT - Prishtina është bërë destinacion edhe i një ngjarjeje të madhe kulturore. Këtë herë bëhet fjalë për festivalin e yllit botëror të muzikës, Dua Lipa.

Mbrëmjen e 4 gushtit mijëra adhurues të muzikës janë mbledhur në Parkun Nacional të Gërmisë për ta shijuar performancën e Dua Lipës dhe të artistëve të ndryshëm.

Dua Lipa e nisi performancën e saj para publikut në Prishtinë pas mesnatës.

E shoqëruar nga publiku, Dua Lipa këndoi disa prej këngëve të saj dhe "New Rules" ishte një prej këngëve që ndezi më së shumti atmosferën.

Dua Lipa është me prejardhje nga Kosova. Ajo u kthye që të performonte në edicionin e tretë të Festivalit që sjell shumë emra të mëdhenj të muzikës botërore, por edhe lokale.

Para hapjes zyrtare të festivalit, në një konferencë për medie, Dua Lipa tha se nuk ka ndjenjë më të mirë sesa performimi në Prishtinë. "Po më vjen shumë mirë që jam në shtëpinë time, në vendin tim dhe të kem mundësi të bëj diçka të tillë", tha Dua Lipa.

Festivali "Sunny Hill", që nisi të enjten, do të zgjasë deri më 7 gusht dhe këtë vit, sipas organizatorëve, do të ndiqet nga mbi 25 000 persona çdo ditë.


Por ende pa përfunduar dielli, Parku Nacional i Gërmisë u vërshua nga adhurues të muzikës, kryesisht të rinj, të cilët me emocione e prisnin nisjen e Festivalit.

Nga Londra kishte ardhur edhe një grua, e cila kishte diçka të përbashkët me yllin e muzikës, Dua Lipa.

Donika Qelaj, 19-vjeçare me prejardhje nga Kosova, por që ka lindur dhe është rritur në Mbretërinë e Bashkuar, erdhi që ta ndjekë performancën e Dua Lipës, me të cilën kishte shkuar bashkë në shkollë. "Jam e afërt me motrën e saj. Jemi miq familjarisht. Ka qenë shumë interesante ta shohësh teksa lulëzon në një artiste inspiruese", thotë ajo për "Radion Evropa e Lirë".

Donika Qelaj vendosi që në "Sunny Hill" të vinte me të dashurin e saj, Marlow Depeza.

Depeza thotë se për festivalin dëgjoi nga e dashura dhe se pret të kalojnë mirë. "Më pëlqen Kosova, më duket mirë. Më duket çuditshëm të jem i huaji këtu, por po kalojmë mirë", thotë ai.



Me moton "Set me free" (Më lër të lirë), edicioni i sivjetmë bën thirrje për liberalizimin e vizave për Kosovën. "Përderisa BE-ja vendos kufij rreth lirisë sonë, ne do ta mbajmë të gjallë dhe ta lirë imagjinatën tonë", ka njoftuar Festivali në një njoftim në "Facebook".

Kosova mbetet shteti i vetëm në Ballkanin Perëndimor që ka regjim të vizave për udhëtim në shtetet e Zonës Shengen.

Ideja për trajtimin e kësaj çështjeje po i duket interesante edhe DriLona Kurtalani, 25-vjeçares nga Gjilani. "Nuk besoj që festivali do të ketë shumë ndikim në liberalizim të vizave, por prapë është mirë që po e përçojnë një mesazh sepse jemi goxha të izoluar", thotë Kurtalani.

Ajo thotë se në Festivalin "Sunny Hill" ka ardhur më shumë që ta ndjekë performancën e Dua Lipës, pasi e cilëson atë si artiste inspiruese. "Festivali që organizohet nga Fondacioni 'Sunny Hill', i këngëtares Lipa, e solli në Kosovë edhe Adrian Misirajn, i cili është nga Skenderaj, por që aktualisht studion në Gjermani. "Unë i kam blerë biletat ende pa u bërë publikë artistët që do të performojnë. Mendoj se Diplo do të jetë performuesi i preferuar", thotë ai.

Çmimet e biletave për këtë festival variojnë nga 70 deri në 350 euro.

Para vendosjes për mbajtjen e festivalit në Parkun e Gërmisë pati kundërtënie lidhur me lokacionin e festivalit.

Edicioni i parë i Festivalit "Sunny Hill" është mbajtur më 2018. Për shkak të pandemisë së koronavirusit, edicioni i vitit 2020 ishte anuluar.

Përveç Festivalit "Sunny Hill", nga 22 korriku deri më 30 tetor Prishtina është nikoqire edhe e Bienales Evropiane Nomade - Manifesta.

Ndërkaq, më 5 gusht, në Prizren nis Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër "DokuFest".



SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS THEKSOJNË SE TEMA PËR ASOCIACIONIN E KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE PRITET TË DISKUTOHET GJATË KËTIJ MUAJI NË BRUKSEL

Escobar: Asociacioni nuk duhet të jetë shtet brenda shtetit

I dërguari i Posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka theksuar se krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nuk duhet të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe të krijojë “shtet brenda shtetit”. “Ne kemi qenë të qartë se palët janë pajtuar më herët për Asociacionin, prandaj duhet të diskutohet”, ka deklaruar ai, duke besuar se kjo temë do të diskutohet gjatë këtij muaji në Bruksel

“Epoka e re”

Prishtinë, 5 gusht - I dërguari i Posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka pohuar se krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nuk duhet të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe të krijojë “shtet brenda shtetit”. Gjatë një bashkëbisedimi me gazetarët, Escobar ka thënë se qëndrimi i ShBA-së është që të zbatohen të gjitha marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi, por ka thënë se duhet të ketë diskutim për çështjen e Asociacionit, që të mos bie ndesh me ligjet, raporton “Radio Evropa e Lirë”. “Ne kemi qenë të qartë se palët janë pajtuar më herët për Asociacionin, prandaj duhet të diskutohet. Megjithatë, Asociacioni nuk duhet të ndërhyjë, nuk duhet të

bie në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, nuk duhet të krijojë probleme në funksionalitetin e Kosovës dhe nuk duhet të jetë shtet brenda një shteti”, ka deklaruar Escobar. Escobari tha se ka modele të shumta evropiane, ku minoritetet mund ta mbrojnë trashëgiminë e tyre kulturore dhe gjuhën amtare, por pa shkelur kornizën kushtetuese të vendit ku jetojnë. “Ne duam të gjejmë disa prej këtyre shembujve dhe, ndoshta, edhe t’i përdorim si udhëzues për ta zbatuar Asociacionin. Prandaj, kam shpresë se mund t’i diskutojmë këto në Bruksel më vonë gjatë këtij muaji”, shtoi ai. Kosova dhe Serbia kanë arritur më 2013 Marrëveshjen për Asociacionin në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Dy vjet më vonë palët kanë nënshkruar Marrëveshjen mbi parimet e themelimit të Asociacionit. Por,

po atë vit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës tha se disa pika të marrëveshjes nuk ishin në harmoni me aktin më të lartë juridik dhe tha se ato mund të harmonizohen me akte nënligjore të qeverisë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kundërshton një asociacion njëetnik, ndërkaq Serbia insiston në krijimin e tij.

Më 18 gusht Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen në Bruksel për ta vazhduar dialogun dhe Escobar tha se shpreson që në këtë takim të flitet edhe për Asociacionin. Escobari tha se për Shtetet e Bashkuara çështja e Kosovës “nuk është çështje e hapur”, pasi Uashingtoni dëshiron që Kosova të njihet prej të gjitha shteteve të BE-së dhe të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare. Ai tha se ShBA-ja mbështet “plotësisht dialogun e lehtësuar nga BE-ja”. “Ne besojmë se ka një zgjidhje të përhershme për çështjen e targave të makinave. Besoj se jemi afër zbatimit të udhërrëfyesit për energjinë në veri, jemi afër nënshkrimit të marrëveshjes për të pagjeturit dhe shpresoj që palët do ta nënshkruajnë këtë marrëveshje shumë shpejt. Dhe sikurse sekretari [amerikan i Shtetit, Antony] Blinken u tha presidentes [Vjosa Osmani] dhe [Albin Kurti] kryeministrit të

Kosovës kur ishin në ShBA, ne duhet ta nisim diskutimin për Asociacionin”, tha ai.

Kosova dhe Serbia zhvillojnë diskutime në Bruksel nën ndërmjetësimin e BE-së që nga viti 2011. Procesi i dialogut ka për

synim normalizimin e plotë të raporteve.

Kosova kërkon që një marrëveshje përfundimtare ta përfshijë njohjen reciproke, ndërkaq Serbia insiston në një zgjidhje kompromisi.

Çfarë parasheh Asociacioni?

Asociacioni i komunave me shumicë serbe parashikohet që të mbledhë rreth vetes dhjetë komuna në Kosovë të banuara me shumicë serbe: Mitrovicë e Veriut, Klokot, Partesh, Ranillug, Graçanicë, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Leposaviq dhe Shtërpçë. Sipas marrëveshjeve, Asociacioni ka për qëllim t’i përfaqësojë interesat kolektive të këtyre komunave, veçmas në fushën e arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural si dhe të ekonomisë. Marrëveshja e vitit 2013 për Asociacionin thekson se ai do të krijohet me statut dhe strukturat e tij, mbi bazën e statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Po ashtu, thuhet se Asociacioni do të ushtrojë edhe përgjegjësi të tjera shtesë, varësisht se si delegohen nga autoritetet qendrore dhe që do të ketë një rol përfaqësimi tek autoritetet qendrore.

Sipas marrëveshjes së vitit 2015 për parimet për krijimin e Asociacionit, objektivat kryesore të Asociacionit janë: ushtron vështrimin e plotë për zhvillimin e ekonomisë lokale; ushtron vështrimin e plotë në fushën e arsimit; ushtron vështrimin e plotë për përmirësimin e shëndetësisë lokale primare e sekondare dhe përkujdesjen sociale; ushtron vështrimin e plotë për koordinimin e planifikimit urban dhe rural; aprovon masa për përmirësimin e kushteve lokale të jetesës për të kthyerit në Kosovë; zhvillon, koordinon, lehtëson aktivitete hulumtuese dhe zhvillimore; promovon, shpërndan dhe avokon për çështjet me interes të përbashkët të anëtarëve të tij dhe i përfaqëson ata tek autoritetet qendrore; vendos marrëdhënie dhe hyn në marrëveshje bashkëpunimi me asociacionet e tjera të komunave, vendore dhe ndërkombëtare etj.

Çfarë në të vërtetë bën Lista Serbe në institucionet e Kosovës?

Zyrtarë të Listës Serbe shpeshherë thonë në publik se kjo parti politike është përfaqësuesja e vetme ligjore dhe legjitime e serbëve në institucionet e Kosovës, por zëri i tyre pothuajse asnjëherë nuk dëgjohej në Kuvendin apo Qeverinë e Kosovës

PRISHTINË, 5 GUSHT - Zyrtarë të Listës Serbe shpeshherë thonë në publik se kjo parti politike është përfaqësuesja e vetme ligjore dhe legjitime e serbëve në institucionet e Kosovës, por zëri i tyre pothuajse asnjëherë nuk dëgjohej në Kuvendin apo Qeverinë e Kosovës, sepse rrallëherë marrin pjesë në seanca ose mbledhje.

Lista Serbe, e afërt me Partinë Progresive Serbe të presidentit serb Aleksandër Vuçiq, është partia e vetme që përfaqëson serbët në institucionet e Kosovës, gjegjësisht, i vetmi opion politik serb që merr pjesë në punën e institucioneve qendrore dhe lokale të Kosovës.

Pikërisht për këtë arsye, më 3 gusht, shoqëria civile nga radhët e komunitetit serb e ftoi Listën Serbe që të marrë përgjegjësinë mbi vete dhe të marrë pjesë në mënyrë aktive në punë, në mënyrë që përmes kanaleve institucionale t'i japë fund destabilitetit dhe të kontribuojë për paqen.

Tensionet e fundit në Kosovë u ngritën më 31 korrik, para fillimit të procesit të rirregjistrimit të targave serbe me emërtimet e qyteteve të Kosovës në targa RKS (Republika e Kosovës), si dhe vendosjes së masave reciproke lidhur me letërnjoftimet që lëshohen nga organet serbe.

Si shenjë proteste, serbët lokalë në katër komuna në veri të Kosovës bllokuan rrugët me kamionë dhe automjete të tjera, ndërkaq Lista Serbe i falënderoi për këtë dhe i inkurajoi.

Ndërkohë, Qeveria e Kosovës, si përgjigje ndaj kërkesës së partnerëve ndërkombëtarë, vendosi të shtyjë për 30 ditë zbatimin e këtyre vendimeve, për shkak të dezinformatave që vinin nga Beogradi për situatën në terren.

“Lista Serbe nuk ka komunikim me qytetarët”

Igor Markoviq nga organizata joqeveritare Aktiv nga Mitrovica e Veriut, vlerëson se Lista Serbe është një “bojler që rrjedh” në raport me informacionet që vijnë nga Beogradi dhe se nuk bën pothuajse asgjë për të mbrojtur interesat e serbëve përmes institucioneve në Kosovë. “Lista Serbe nuk i shfrytëzon institucionet në të cilat funksionon dhe të cilat i ka zgjedhur si kanal për artikullimin e interesave të komunitetit serb. Disi duket sikur Lista Serbe është në Serbi e jo në Kosovë”, thotë Markoviq.

Organizata joqeveritare Aktiv është një nga nënshkrueset e njoftimit, me të cilin i bëhet thirrje Listës Serbe që përveç



komunikimit me Beogradin, të vendosë një kanal institucional të komunikimit me kryeministrin e Kosovës.

Igor Markoviq, po ashtu, thotë se përfaqësuesit e Listës Serbe në asnjë mënyrë nuk e kanë njoftuar popullatën lokale për vendimet e Qeverisë së Kosovës dhe as nuk ua kanë shpjeguar se për çfarë bëhet fjalë. Ai thekson se qytetarët pothuajse nuk kanë pasur asnjë informacion. “Informatat e vetme që vinin nga përfaqësuesit e tyre legalë në institucionet e Kosovës, ishin të dobëta dhe me përmbajtje me karakter konflikti. Në vend se të ishin në Kuvend (të Kosovës), kur bisedohej për atë udhëzim administrativ, ata nuk morën pjesë aty. Është një hap që është dashur të përdoret, jo vetëm për qetësimin paraprak të tensioneve, por edhe për rregullimin më të mirë të asaj fushe”, konsideron ai.

Sipas tij, secila krizë në Kosovë ka ndikim të drejtpërdrejtë në shpërnguljen e pjesëtarëve të komunitetit serb, të cilët, siç thotë ai, janë nën presionin e pasigurisë së vazhdueshme.

Lista Serbe: Qëllim të vetëm kemi rrëzimin e qeverisë së Kurtit

Radio Evropa e Lirë (REL) i është drejtuar Listës serbe me pyetjen se a do t'i dëgjojë thirrjet e shoqërisë civile për të rritur bashkëpunimin me kryeministrin e Qeverisë së Kosovës dhe për të luftuar për të drejtat e serbëve përmes institucioneve të Kosovës. Por, deri në publikimin e këtij teksti askush nga ky subjekt politik nuk është përgjigjur.

Megjithatë, Lista Serbe ka bërë

një njoftim publik, më 3 gusht, për t'u përgjigjur deklaratave të ministrit të Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, i cili ka thënë se Lista Serbe është “zhvlerësuar politikisht” dhe se bashkëpunon me grupe kriminale.

Ndër të tjera, Lista Serbe ka deklaruar se nuk bashkëpunon me Qeverinë e Kosovës, në krye të së cilës është Albin Kurti, sepse ajo “punon kundër interesave të popullit serb” dhe se qëllimi politik i këtij subjekti politik është rrëzimi i kësaj qeverie.

Radio Evropa e Lirë i është drejtuar edhe Qeverisë së Kosovës me pyetjen se pse nuk ekziston bashkëpunim më i madh me përfaqësuesit politikë të serbëve në institucionet e Kosovës, por përgjigja nuk ka arritur.

Në Qeverinë aktuale të drejtuar nga Albin Kurti, Lista Serbe udhëheq Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, por nuk është pjesë e koalicionit qeverisës. Në Kuvendin e Kosovës, kjo listë ka dhjetë ulëset e garantuara për komunitetin serb dhe po ashtu udhëheqë me të dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë.

Lista Serbe është formuar në vitin 2013 me mbështetjen e Beogradit zyrtar. Që atëherë, gati se në të gjitha zgjedhjet e mbajtura në Kosovë, ajo ka fituar mbi 90 për qind të votave, ndërkohë që ka eliminuar tërësisht partitë tjera politike serbe.

Çfarë presin banorët lokalë nga Lista Serbe?

Stanko nga Mitrovica e Veriut pret që Lista Serbe t'i ndjekë udhëzimet e presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, dhe jo ato të kryeministrit të Kosovës, Albin

Kurti.

Megjithatë, ai konsideron se Lista Serbe do të duhej të punonte për uljen e tensioneve, atëherë ku ato ndodhin për shkak të vendimeve politike. “Këtë duhet ta bëjnë (t'i ulin tensionet), por edhe të luftojnë atje (në institucionet e Kosovës). Por, nëse nuk munden, atëherë le t'i braktisin ato, çfarë duan më shumë atje”, thotë Stanko.

Edhe bashkëqytetari i tij, Radisha, mendon se Lista Serbe duhet të punojë në zbutjen e marrëdhënieve dhe qetësimin e tensioneve, në mënyrë që të mos përshkallëzohet situata.

“Presidenti ynë (i Serbisë, Aleksandar Vuçiq) thotë, ne kemi fituar ose do të fitojmë. Jo. Këtë nuk guxon as ai ta thotë. Duhet ngadalë dhe me qetësi, të flasë, të flasë dhe të flasë. Si fqinj me fqinj, si thonë, rreth kufirit. Ashtu duhet të bisedojmë ne. Me inate askush nuk ka krijuar kurrë asgjë. Në atë mënyrë nuk do të mund ta bëjë as këtu. Vetëm përmes rrugës paqësore gjithçka mund të zgjidhet”, thotë ai.

Serbët që jetojnë në anën jugore të lumit Ibër, e përkrahin më shumë bashkëpunimin mes Listës Serbe dhe Qeverisë së Kosovës, sepse besojnë se do të përfitojnë qytetarët.

Vesna nga Graçanica, komunë me shumicë serbe afër Prishtinës, thotë se përfaqësuesit politikë të serbëve duhet të bashkëpunojnë më shumë me Qeverinë e Kosovës për të evituar tensionet, sepse siç thotë ajo, paqja është parakusht themelor për një jetë më të mirë të qytetarëve. “Duhet të ketë marrëveshje mes tyre (në mes të Listës Serbe dhe Qeverisë së Kosovës), që çdo gjë të jetë mirë, në të mirë të këtij populli, që të

mbijetojë”, thotë Vesna.

Milani beson se qytetarët asnjëherë nuk kontribuojnë në ngritjen e tensioneve, por këtë e bëjnë politikanët nga radhët e komunitetit serb dhe shqiptar. Ai thekson se pikërisht politikanët janë ata që duhet të bashkëpunojnë për normalizimin e marrëdhënieve dhe përmirësimin e pozitës së serbëve në Kosovë.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, më 4 gusht, ka biseduar me kryetarin e Listës Serbe, Goran Rakiq, për zhvillimet e fundit në veri të Kosovës, ku jeton popullata shumicë serbe. Ai ka theksuar rëndësinë e shmangies së përshkallëzimit të situatës.

Ambasadori Hovenier ritheksoi qëndrimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), se vendimi i Qeverisë së Kosovës për vendosjen e masave reciproke ndaj Serbisë, është në harmoni me Marrëveshjen e Brukselit, të cilën Prishtina dhe Beogradi e nënshkruan në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Me Hovenierin është pajtuar edhe kryetari i Listës Serbe, Rakiq, i cili është edhe ministër për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës.

Në një komunikatë të veçantë, ai ka thënë se kriza e ndodhur ditëve të kaluara mund të zgjidhet përmes dialogut, si dhe duke respektuar plotësisht nevojat elementare, kur është fjalë për funksionimin normal të serbëve. Rakiq ka thënë gjithashtu se Lista Serbe do të jetë një partner konstruktiv në vendimmarrje dhe se kriza që ekziston sot mund të tejkalohet vetëm me vullnetin e sinqertë të të gjitha palëve.

Latifi viziton Barnatoren Qendrore të ShSKUK-së, njoftohet për situatën rreth furnizimit me barna

PRISHTINË, 5 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, i shoqëruar edhe nga u.d. e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Universitar të Kosovës, dr. Pranvera Zejnullahu-Raci, vizituan të premtën Barnatoren Qendrore të ShSKUK-së.

Nga menaxhmenti i kësaj barnatoreje, ministri Latifi u njoftua për situatën rreth furnizimit me barna, me

infrastrukturën aktuale dhe me sfidat që janë aty.

Ministri Latifi tha se do t'i japë mbështetje përmirësimit të infrastrukturës së këtij institucioni shëndetësor për zhvillimin e kapaciteteve profesionale shëndetësore, në mënyrë që barnat të kenë kushtet e sigurisë së lartë të ruajtjes dhe furnizimi i ShSKUK-së me to të bëhet në mënyrë të rregullt.

Kurse u.d. i drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Universitar të Kosovës, dr. Pranvera Zejnullahu-Raci, bashkë me menaxhmentin e Barnatores Qendrore, falënderuan ministrin për vizitën, duke vlerësuar se përmirësimi i kushteve dhe infrastrukturës dhe ndryshimi strategjik i furnizimit me barna do t'u mundësojë shërbime më të mira pacientëve.



Shërbimi Korrektues pranon donacionin e radhës nga ambasada e ShBA-së



PRISHTINË, 5 GUSHT - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka pranuar donacionin e radhës nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përkatësisht nga Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL).

Pranim-dorëzimi i donacionit u nënshkrua nga zëvendësuesi i drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Sami Gashi dhe drejtori i Byrosë për Çështje Ndërkombëtare të

Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) në Kosovë, Shawn Waddoups.

Në donacion përfshihen tabela elektronike, kamera sigurie, databaza dhe monitorë të ndryshëm përmes së cilëve zyrtarët korrektues nga Qendra Operative e Shërbimit Korrektues të Kosovës do t'i monitorojnë të gjitha qendrat korrektuese dhe ato të paraburgimit.

Donacioni do të ndikojë në rritjen e nivelit të sigurisë brenda dhe jashtë

institucioneve korrektuese, ka për qëllim luftimin dhe parandalimin e dukurive negative, po ashtu edhe përmirësimin e kushteve të punës së përditshme të zyrtarëve korrektues.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me donacionet e saj përmes INL & ICITAP ka mbështetur dhe po vazhdon ta mbështesë zhvillimin e ShKK-së në ndërtimin e një sistemi të avancuar, të pavarur, të sigurt dhe të vetëqëndrueshëm.

Plagjiatura në UP, Nagavci: Urgjentisht duhet të bëjmë ndryshime

PRISHTINË, 5 GUSHT - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka thënë se me shqetësim ka pranuar njoftimet për verifikim të rasteve të plagjiaturës nga ana e personelit akademik të Universitetit të Prishtinës. Ajo ka thënë se ndonëse plagjiatura konsiderohet forma më e rëndë e shkeljes së etikës akademike, jam e vetëdijshme se trajtimi i denoncimeve për plagjiaturë nga organet përkatëse të institucioneve akademike është sfidues.

“Mirëpres shqyrtimin e rasteve nga Këshilli i Etikës i UP-së, por konsideroj se masat e shqiptuara të pezullimit nga mentorimi i punimeve të diplomës nuk janë adekuate, sepse nuk shpërfaqin gjykimin shoqëror në raport me praktikën e tilla brenda



komunitetit akademik dhe nuk i dekurajojnë ato. Andaj pres nga organet përgjegjëse të Universitetit që t'i rishikojnë masat e shqiptuara nga Këshilli i Etikës, duke siguruar respektimin e standardeve të ndershmërisë akademike brenda institucionit”, ka thënë ajo.

Nagavci ka thënë se si ministre e Arsimit do t'i drejtohet Këshillit Drejtues të UP-së me kërkesë që të gjitha organet e universitetit t'i trajtojnë me seriozitet këto dhe rastet e ngjashme. “Me Projektligjin e ri për Arsimin e Lartë, i cili së shpejti do të jetë në diskutim publik, kemi paraparë

masa të veçanta për parandalimin e të gjitha formave të cenimit të integritetit akademik, përmes formimit të Komitetit Etik në nivelin qendror, si dhe obligimit që të gjitha institucionet e arsimit të lartë të kenë këshilla të etikës. Po ashtu, Projektligji parasheh një afat të

arsyeshëm brenda të cilit i gjithë personeli akademik duhet të jetë në gjendje t'i arsyetojë thirrjet akademike në pajtim me standardet e përcaktuara me ligj”, ka deklaruar Nagavci.

Ajo ka theksuar se gjendjen në Universitetin e Prishtinës nuk e kemi të mirë dhe, sipas saj, kjo është evidentuar së fundmi edhe në ranglistën prestigjioze “Webometrics”, sipas së cilës, vazhdon rënia e UP-së në rangim. “Kjo është e papranueshme dhe s'mund të vazhdojë. Urgjentisht duhet të bëjmë ndryshime që të përmirësojmë këtë gjendje. Stafi akademik duhet të ketë persona me integritet e kredibilitet të lartë profesional dhe personal. Andaj edhe angazhimi ynë për ta përmirësuar këtë gjendje do të jetë këmbëngulës e pa hezitim”, është shprehur ministrja Nagavci.

Nura dhe Lushtaku vizitojnë familjen e Thaçit në Burojë

SKENDERAJ, 5 GUSHT - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, së bashku me nënkryetarin Sami Lushtaku, kanë vizituar familjen e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në Burojë, me rastin e ditëlindjes së nënës së tij, zonjës Hyrë, e cila mbushi

85 vjet.

Kryetari Nura dhe nënkryetari Lushtaku i kanë uruar nënës së Thaçit shëndet të plotë bashkë me familjen. Ata, gjithashtu, i kanë uruar që ditëlindjen e radhës të festojë bashkë me presidentin Hashim Thaçi. Hyrë Thaçi njihet si një grua

e respektuar që ushquu me bukë gjatë ilegalitetit luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ajo dhe bashkëshorti i saj, bacë Haxhi Thaçi, janë krenarë për të birin dhe për gjithë trashëgiminë e tij ushtarake e politike në shërbim të lirisë së vendit.



BIK-u i drejtohet Kurtit, kërkon që të lejohet bartja e shamisë në shkolla

PRISHTINË, 5 GUSHT - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës i është drejtuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, që ta shfuqizojë një urdhërese administrative për lejimin e shamisë në institucione publike. Sipas Tërnavës, kjo kërkesë është e BIK-ut dhe e besimtarëve myslimanë. “Është kërkesë e kamotshme e kryesisë së BIK-ut, institucioneve të saj dhe besimtarëve myslimanë që

të shfuqizohet, respektivisht të hiqet e tëra pika 1.13 e nenit 3, në Udhëzimin Administrativ 06/2014, ngaqë është diskriminuese dhe, si e tillë, në disa raste ka pasur tentime që, duke u thirrur në këtë udhëzim, respektivisht në këtë nen, t’u mohohet e drejta e shkollimit nxënësve që bartin mbulesën myslimane - shaminë. Kërkojmë nga organet kompetente, Ministria e Arsimit, e Shkencës e

Teknologjisë, si dhe nga kryeministri z. Albin Kurti, që sa më parë ta anulojnë këtë vendim, që në vete është diskriminues ndaj qytetareve të Kosovës - fëmijëve tanë. Mirëpo, kjo kërkesë e kamotshme e BIK-ut nuk duhet politizuar e as polarizuar, por duhet trajtuar me përgjegjësi dhe korrektësi maksimale”, është thënë në kërkesën e Tërnavës.



ShSKUK-ja përfiton pajisje mjekësore nga KFOR-i

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 GUSHT - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka përfituar donacion të pajisjeve mjekësore nga KFOR - MSU Carabinieri nga Italia. Pajisjet e dhuruara do të shërbejnë për Klinikën e Pediatrisë dhe atë të Neonatologjisë. Donacioni përmban infratavolinë për Repartin Intensiv Pediatrik me dy respiratorë, për tre moduse infatil, pediatrik dhe adult, po ashtu dy monitorë transportues me pesë parametra.

Në ceremoninë e dorëzimit pranimit të donacionit morën pjesë ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ambasadori italian në Kosovë, Antello De Riu, u.d. drejtoresha e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të

Kosovës, Pranvera Zejnullahu Raci, Gen. Luca Piperni (ITA) KFOR DCOM si dhe komandanti i Karabinierëve KFOR - MSU koloneli Maurizio Mele.

Dr. Zejnullaju - Raci, u.d. drejtoreshë e ShSKUK-së, ka falënderuar shtetin italian dhe KFOR-in për këtë donacion shumë të nevojshëm për trajtimin e pacientëve.

Fjalë falënderimi për donacionet e vazhdueshme nga shteti italian tha edhe ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, i cili tregoi angazhimet konkrete për përmirësim të shërbimeve shëndetësore për pacientët.

Ambasadori italian në Kosovë, Antello De Riu, përmendi bashkëpunimet dhe ndihmesat që ka dhënë shteti i Italisë për popullin e Kosovës, me theks të veçantë për Shërbimin e



Kardiokirurgjisë dhe atë të Mikrobiologjisë, por edhe gjatë Pandemisë së Covid-19.

Për donacionin e sotëm foli edhe general Luca Piperni nga KFOR-i italian, i cili tregoi për

punën që kanë bërë deri në realizimin e donacionit dhe bashkëpunimet e mëhershme.

Policia me aktivitete shtesë për ngritjen e sigurtisë në trafik



MITROVICË, 5 GUSHT - Me qëllim të ngritjes së masave të sigurtisë në trafikun rrugor, në kuadër të planit operativ “Sezoni veror 2022”, në zonën e përgjegjësisë së Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicën e Jugut, kanë filluar së realizuari aktivitete shtesë për rrezikun dhe pasojat ligjore dhe të sigurtisë nga mosbartja e helmetës gjatë ngasjes së motoçikletës. “Përmes angazhimeve të shtuara policore synohet vetëdijesimi i pjesëmarrësve në trafik, në veçanti i ngasësve të motoçikletave për mbajtjen e helmetës gjatë ngasjes së

motoçikletës, ku njëkohësisht ngasësve po u shpërndahen edhe fletushka me moton ‘Mosbartja e helmetës rrezikon jetën e ngasësit’. Realizimi i këtyre masave preventive edhe një herë dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm të policisë për parandalim dhe ngritje të masave të sigurtisë së pjesëmarrësve në trafik”, është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës, duke u bërë thirrje të gjithë pjesëmarrësve në trafikun rrugor të kenë kujdes dhe t’u përmbahen rregullave të përcaktuara me Ligjin për Sigurinë në Trafik.

1 266 raste të reja me Covid në Kosovë

Prishtinë, 5 gusht - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit nga 3 609 testime kanë konfirmuar 1 266 raste të reja me Covid.

Në këtë periudhë kohore nuk ka pasur persona të vdekur nga ky virus.

Në 24 orët e fundit janë shëruar 1 606 persona, ndërkaq raste aktive janë 9

252. Brenda 24 orëve janë vaksinuar vetëm 64 persona.

Një treg i kafshëve në qytetin Vuhan të Kinës, ka qenë epiqendra e pandemisë së koronavirusit, sipas dy studimeve të reja që janë publikuar në revistën shkencore, Science.

Për koronavirusin e ri, që

shkakton sëmundjen Covid-19, është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur koronavirusin si pandemi më 11 mars të vitit 2020.

Deri më tani janë regjistruar mbi 6 milionë njerëz të vdekur me këtë virus



AKP-ja heq nga tenderi gjashtë asete

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 GUSHT - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka bërë me dije se ka tërhequr nga tenderi i shitjes gjashtë asete, duke respektuar kërkesën e komunës së Prishtinës, kërkesën e komunës së Podujevës dhe kërkesën e komunës së Dragashit mbi shpalljen e zonave të interesit publik dhe inicimin e proceseve të shpronësimit.

“Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton opinionin publik se ka tërhequr nga tenderi i shitjes gjashtë asete, duke respektuar kërkesën e komunës së Prishtinës, kërkesën e komunës së Podujevës dhe kërkesën e komunës së Dragashit mbi shpalljen e zonave të interesit publik dhe

inicimin e proceseve të shpronësimit. Njësitë e larguara nga shitja janë: Njësia nr. 14-KB Drita Toka në Shajkoc; Njësia nr. 15-KB Flora Toka në Pakashticë të Epërme; Njësia nr. 16-KB Përparimi Toka në Miroc; Njësia nr. 19-Agrokosova Zyrat në Dardani; Njësia nr. 22-KB Liria Toka në Siçevë; Njësia nr. 33-NSH Koritniku-Shitorja në fshatin Kërstec, Dragash. Këto asete ishin paraparë për t'u shitur përmes tenderit publik, shitjes së aseteve përmes likuidimit (SHAL) 57, që do të mbahet më 10 gusht 2022. Dita për dorëzimin e ofertave për asetet e (SHAL) 57 është më 10 gusht 2022 nga ora 10:00 deri në orën 12:00, kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë duke filluar nga ora 12:30”, theksohet në komunikatën për medie të AKP-së.



Publikohet lista e vendeve më të pasura në botë, Kosova në pozitën e 105-të

PRISHTINË, 5 GUSHT - Do të pëlqenit të ishit të pasur në një vend të varfër apo të varfër në një të pasur? Matja se sa i pasur është një vend nuk është aq e lehtë (nuk ka të bëjë vetëm me GjDP-në).

Matja se sa i pasur je varet në një masë të madhe nga sa përkufizohen vendet e pasura dhe të varfra, shkruan revista “Global Finance”. Gazeta në hulumtimin e saj, “Vendet më të pasura dhe më të varfra në botë”, e ka renditur Kosovën në vendin e 105.

Sipas kësaj liste, vendet më të pasura në botë janë Luksemburgu, Singapori, Irlanda dhe Katari. Më të varfërat janë Siria, Afganistani, Libani dhe Ukraina.

Duke parë rajonin, Kroacia renditet në vendin e 53, Mali i Zi në vendin e 69, Serbia në vendin e 72, Maqedonia e Veriut në vendin e 78, Bosnja-Hercegovina në vendin e 88 dhe Shqipëria në vendin e 92. “Nëse thjesht



marrim parasysh produktin e brendshëm bruto të një vendi, shumica e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga vendi gjatë një viti - atëherë do të duhet të konkludojmë se kombet më të pasura janë pikërisht ato me GjDP-në më të lartë Shtetet e Bashkuara, Kina, Japonia dhe Gjermania”, shkruan revista e lartpërmendur. Një problem tjetër me GjDP-në është, siç shkruan “Global Finance”, se nuk mat

shpërndarjen e pasurisë. “Kjo është arsyeja pse një përfaqësim më i saktë i kushteve të jetesës së njerëzve fillon me ndarjen e GjDP-së kombëtare me numrin e njerëzve që jetojnë atje: GjDP për frymë dhe shkalla e rritjes së saj na tregojnë shumë më tepër për pasurinë sociale që është potencialisht e disponueshme për çdo person dhe nëse kjo pasuri po rritet ose zvogëlohet me kalimin e kohës”, thuhet në tekst.

90	Albania	17,383
91	Suriname	17,300
92	Brazil	17,208
93	Azerbajjan	17,153
94	Moldova	16,719
95	St. Lucia	16,509
96	Armenia	15,818
97	St. Vincent and the Grenadines	15,505
98	Sri Lanka	15,387
99	South Africa	15,361
100	Peru	15,035
101	Egypt	14,928
102	Indonesia	14,535
103	Dominica	14,491
104	Paraguay	14,430
105	Kosovo	13,964
106	Palau	13,652
107	Fiji	13,598
108	Mongolia	13,350
109	Algeria	13,002
110	Bhutan	12,967
111	Vietnam	12,881
112	Ecuador	12,664

Azemi: Punëtorët e sektorit privat po diskriminohen

PRISHTINË, 5 GUSHT - Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka kritikuar qeverinë se nuk po merret me çështjet që kanë të bëjnë me punëtorët e sektorit privat.

Në një intervistë për “Ekonomia Online”, ai ka thënë se nuk kanë zhvilluar asnjë takim me qeveritarët duke shtuar se qeveria është “bunkerizuar” dhe se nuk është duke i përfillur kërkesat e tyre. “Realisht ne nuk kemi pasur dhe nuk do të kemi pushime sepse problemet e mëdha të sektorit privat në Kosovë nuk na

lejojnë të kemi pushime. Nuk kemi pasur takime me qeveritarë pasi ata janë ‘bunkerizuar’ dhe nuk po merren me problemet e sektorit privat. Ne po presim që kërkesat tona së paku për 100 euro të përsëriten për ata që nuk kanë përfituar pas gabimeve në mbushjen e aplikacioneve. Jemi duke e përcjellë gjendjen e punëtorëve, sepse në sektorin publiko-privat pushimet e punëtorëve po keqpërdoren”, ka deklaruar Azemi.

Sipas tij, shkeljet më të mëdha që po u bëhen punëtorëve po

vijnë nga kompanitë që po punojnë për shtetin, madje edhe po diskriminohen. “Fatqësisht në vend se Ministria e Financave të jetë avangarde, kjo ka stagnuar dhe sot në Prokurorinë e Shtetit kemi pagë që ka qenë 200 euro dhe është kthyer në 170 euro. Realisht jemi shumë të zhgënjyer për këtë bashkëpunim me qeverinë. Ne nuk mund të bëjmë diçka më shumë. Tani nuk po e kemi ndihmën e shtetit kur po bëhen shkelje të të drejtave të punëtorëve”, ka thënë Azemi.



Mitet e Platonit



Neel Burton

Ndoshta alegoria më e famshme në filozofi është Alegoria e Shpellës së Platonit, në të cilën Platoni, nëpërmjet Sokratit, krahason njerëzit të cilëve u mungon mesimi filozofik, me të burgosurit që kanë kaluar tërë jetën e tyre në një shpellë të nëndheshme dhe nuk e kuptojnë se ekziston një botë e madhe, përtej asaj që ata perceptojnë. Alegoria e Shpellës nuk është tamam një mit, për aq sa i mungon dimensionin i shenjtë që është thelbi i mitit. Por Platoni shkroi gjithashtu mitet e 'mirëfillta' në dialogët e tij sokratike, duke kapërcyer kështu – dhe në mënyrë të pazakontë për kohën – ndarjen e mprehtë midis mitos dhe logos: midis rrëfimit dhe ligjërimit të arsyetuar. Platoni nuk shkroi argumente analitike të thata, por dialogë të gjallë fikтивë ose gjysmëfikтивë, duke e bërë atë një nga filozofët më të lexueshëm nga të gjithë. Dialogët e tij të mëparshëm paraqesin Sokratin duke pyetur një ose më shumë njerëz për kuptimin e një koncepti të veçantë, si bukuria, guximi ose devotshmëria, në mënyrë që të ekspozojë kontradiktat në supozimet e tyre dhe të provokojë një rivlerësim të konceptit – një metodë debati që është bërë e njohur si metoda e elenchus ('përgënjeshttrimi') ose metoda Sokratike. Në dialogët e tij, Platoni thuri mite, alegori dhe metafora. Për


shembull, ai krahasoi shpirtin (aka mendje – psikikë) të një karrocier në një karrocë të tërhequr nga dy kuaj me krahë, njëri i zbutur dhe fisnik (arsyeja), tjetri i egër dhe i padisciplinuar (pasioni). Të gjithë dialogët e tij, me përjashtim të vetëm atij të Kritonit, përmbajnë imazhe kafshësh dhe vetë Sokrati krahasohet në mënyra të ndryshme me një mizë, një mjellmë, një gjarpër, një lejlek dhe një pjell – dhe jashtë mbretërisë së kafshëve, me një kavanoz të zbrazët të mbushur me ide të njerëzve të tjerë dhe një mami, që ndihmon shpirtin shtatzënë të pjellin urtësi. Ky është zëri i MenoS, një general i ri mercenar me prirje filozofike, tek "Meno" e Platonit: "O Sokrat, më thoshin, para se të të njihja, se ti gjithmonë vë në dyshim veten dhe i bën të tjerët të dyshojnë; dhe tani ti po ushtron magjitë e tua mbi mua, dhe unë thjesht po magjepsem e pothuaj po dal mendsh. Dhe nëse mund të guxoj të bëj një shaka me ju, ju më dukeni si në pamjen tuaj ashtu edhe në fuqinë tuaj ndaj të tjerëve, se jeni shumë si peshku silur i sheshit, i cili torturon ata që i afrohen dhe e prekin, siç po bën ti tani me mua. Sepse shpirti im dhe gjuha ime janë vërtet të turbullt dhe nuk di si t'ju përgjigjem... Dhe mendoj se jeni shumë i mençur që nuk jeni larguar nga shtëpia, sepse nëse do kishit bërë në vende të tjera siç bëni në Athinë, do të ju fusnin në burg si magjistar." Platoni përdori edhe mitet

tradicionale dhe të tjera, të cilat ai i përshtati ose i shpiku për qëllimet e tij – mitet më të famshme të shpikura janë Miti i Atlantidës, Miti i Aristofanit dhe Miti i Erit. Po pse duheshin shfaqur mitet? Pse të mos shkruhej thjesht filozofi "e pastër"? Mitet dhe metaforat e Platonit shërbejnë për qëllime të shumta. Për shembull, Miti i Atlantidës shërben si një shpalosje e vizionit të Platonit për një shoqëri ideale. Dhe metafora e Karrocës mbështetet në teorinë e tij të dijes, teorinë e formave dhe teorinë e dashurisë, duke treguar se si të gjitha përshtaten dhe punojnë së bashku: karrocet e shpirtave që janë më të ngjashëm me perënditë janë në gjendje të ngjiten mjaft lart, për të ngritur kokat e tyre mbi pragun e qiellit dhe për të parë format universale. Shpirtat që vështrojnë më gjatë format janë rimishëruar si filozofë, artistë dhe dashnorë të vërtetë dhe janë aq të përfshirë nga ajo që kanë parë, sa që harrojnë gjithçka nga interesat tokësore. Por përtej përdorimeve të tyre thjesht njohëse, mitet e Platonit kanë gjithashtu një funksion të rëndësishëm emocional, duke e bërë filozofinë e tij më të kapshme dhe tërheqëse; madje, herë pas here, goditëse. Pak njerëz dinë për ndërlidhimet e Republikës së Platonit, por pothuajse të gjithë kanë dëgjuar për Atlantis, e cila ka frymëzuar libra të panumërt dhe madje edhe një film të Disney-t. Tek Lisis, Sokrati thotë se bukuria është një "gjë e butë, e lëmuar, e

rrëshqitshme" që "rrëshqet kollaj dhe përshkon shpirtin tanë", dhe mitet e Platonit thjesht pikojnë bukurin. Tek Charmides, Sokrati i tregon Charmides-it të ri, i cili ka vuajtur nga dhimbja e kokës, për një ilaç për dhimbjet e kokës, që e mësoi nga mjeku mistik i mbretit të Trakës. Megjithatë, ky magjistar i madh e kish paralajmëruar se është më mirë të kurosh shpirtin para se të kurosh trupin, pasi shëndeti dhe lumturia në fund të fundit varen nga gjendja e shpirtit: "Ai tha se të gjitha gjërat, të mira e të këqija, në trup dhe në të gjithë njeriun, burojnë nga shpirti dhe përhapen prej andej... Duhet, pra, të trajtohet shpirti para së gjithash, nëse do që koka dhe pjesa tjetër e trupit të jenë mirë. Ai tha se shpirti trajtohet me hijeshi të caktuara, Charmides im i dashur, dhe se këto bukuria janë fjalët e bukura. Si rezultat i fjalëve të tilla, lind vetëkontrolli brenda shpirtave. Kur ai lind dhe është i pranishëm tek ata, atëherë është e lehtë të kesh shëndet, si për kokën ashtu edhe për pjesën tjetër të trupit." Ky është një himn për fuqinë e gjuhës! Për Platonin, miti është një mjet për të anashkaluar arsyen dhe për t'u futur drejtpërdrejt në aspektet më dominuese emocionale dhe irracionale të shpirtit. Është gjithashtu një mjet për të arritur përtej kufijve të arsyes dhe gjuhës, për të kuptuar të vërtetat e thella, madje mistike, një mënyrë, nëse dëshironi, për të thënë të pathënën. Një mit që e krijon Platoni (edhe

pse nuk prezantohet si mit) është historia e origjinës së metodës së elenchus ose vetë dialogut filozofik, që, në fakt, është shumë më përpara Sokratit. Por nëse duhet t'i besohet Platonit, Sokrati filloi metodën e elenchus në përgjigje të një orakulli. Tek Apologjia, Platoni tregon se, një herë e një kohë, miku i Sokratit, Charephon, e pyeti orakullin në Delfi nëse kishte ndonjë më të mençur se Sokrati, dhe priftëresha e Apollonit u përgjigj se nuk kishte njeri më të mençur. Për të zbuluar domethënien e kësaj thënieje hyjnore, Sokrati pyeti një numër njerëzish, që mbaheshin si të mençur për koncepte të ndryshme dhe në secilin rast arriti në përfundimin: "Kam gjasa të jem më i mençur se ai në një masë kaq të vogël, sa që nuk mendoj se e di atë çfarë nuk e di." Që atëherë, Sokrati iu përkushtua shërbimit të perëndive duke kërkuar këdo që mund të ishte i mençur dhe "nëse nuk është, t'i i tregoj se nuk është". Për Platonin, domethënia e këtij miti nuk është se ai i atribuon një origjinë metodës së elenchus, por se e përshkruan mesuesin e tij Sokratin, i cili ishte dënuar me vdekje si heretik dhe korruptues i të rinjve, si njeri që kish qenë në një mision filozofik fisnik, me frymëzim hyjnor.

*Neel Burton është autor i "Kuptimi i miteve" / Philosophy Now – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Humbje në çastet e fundit për 'Dardanët'

PRISHTINË, 5 GUSHT - Kosova ka pësuar humbje minimale nga Irlanda me rezultat 72:73 (22:19, 24:20, 16:15, 10:19) në FIBA Kampionatin Evropian, Divizioni B për meshkuj U18. Kjo ndeshje u zhvillua në garë për vendet 17-22 apo rrethin e

dytë të grupeve. Kosova do të zhvillojë edhe një ndeshje për renditjen përfundimtare. Çereku i parë ishte kryesisht i barabartë, duke përfunduar 22:19. Dardanët ishin më të mirë në periudhën e dytë, ku kishin epërsi deri në nëntë pikë,

44:37, kurse pjesa e parë përfundoi 46:39. Irlandezët u rikthyen furishëm në periodën e tretë për të kaluar në epërsi 50:51, megjithatë basketbollistët e rinj të Kosovës hyn në një seri të suksesshme 8:0, ndërsa shifrat në semafor pas 30

minutash ishin 62:54. Në dhjetë minutat e fundit Irlanda sërish riktheu epërsinë në të mirë në saj, kurse në momentet vendimtare Kosova nuk arriti të shënojë dhe pësoi humbje 72:73. Te Kosova u dalluan Bardh Istrefi me 27 pikë e shtatë



kërcime dhe Olsi Kurtaj me 12 pikë e nëntë kërcime.

Berisha arsyetohet për foton me liderin çeçen: Nuk jam politikan

Një nga futbollistët më të dashur në Kosovë, Bernard Berisha, ka qenë temë diskutimi të premtën, pas publikimit të një foto me liderin çeçen Ramzan Kadyrov, i cili është president i skuadrës ku luan Berisha. Futbollisti nga Peja është arsyetuar për foton duke thënë se nuk është politikan

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 GUSHT - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Berisha, është kritikuar shumë të premtën, pasi ka publikuar në "Facebook" një foto me liderin çeçen Ramzan Kadyrov, i cili është një nga përkrahësit më të mëdhenj të presidentit rus Vladimir Putin. Agresioni rus ndaj Ukrainës po dënohet ashpër nga Shtete e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, NATO dhe të gjitha vendet perëndimore, përfshirë edhe Kosovën. Përveç

me Kadyrovin, Berisha publikoi foto edhe me drejtorin gjeneral të klubit Akhmat Grozny, Magomed Daudov. Pas reagimeve të shumta në rrejtet sociale, të premtën ka reaguar edhe Berisha, i cili është arsyetuar për foton e bërë me liderin çeçen. Ai ka thënë se kjo foto është bërë me rastin e vazhdimit të kontratës dhe se nuk është politikan. "Njerëz të mirë, përhëndetje të gjithëve! Unë foton e kam bërë në 'Facebook' ngase e kam vazhduar kontratën me klubin dhe unë nuk i përkas politikës. Presidenti më respekton shumë

dhe më vlerëson shumë ngase unë jam nga Kosova dhe jam kapiten i ekipit. Ju medie të dashura, faleminderit që gjithmonë e shihni interesin tuaj. Zoti ju ruajt të gjithëve!", ka shkruar Berisha. Ish-futbollisti i Besës së Pejës është i afërt me presidentin e klubit, Akhmat Grozny, pasi kohë me parë golat e shënuara ia dedikonte Kadyrovit dhe ky i fundit i kishte dhuruar një veturë. Berisha është pjesë e Akhmat Groznyt që nga viti 2017, teksa ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2023.



'Daily Mail': Xhaka nën hetim, 'bashkëpunoi me mafien shqiptare'

LONDËR, 5 KORRIK - Granit Xhaka ndodhet në një moment delikat të karrierës së tij. Sipas "Daily Mail", futbollisti i Arsenalit dyshohet se mund të jetë i përfshirë në mafien shqiptare, bashkë me një ish-futbollist profesionist. Hetuesit që në muajin qershor shqyrtuan rastin e kartonit të verdhë që dyshohet se 29-vjeçari e mori qëllimisht, tashmë po merren me këtë çështje. Por, shkruan tabloidi, nuk ka të dhëna të qarta dhe vetë skuadra e Arsenalit nuk ka pranuar të japë komente për çështjen që po hetohet më tej.



Dy muaj më parë Federata e Anglisë iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Krimeve që ta shqyrtonte rastin e Xhakës, pasi në fitoren e Arsenalit kundër Leeds Unitedit në sezonin e

kaluar dyshohet se ai qëllimisht mori karton të verdhë. Më 18 dhjetor 2021 u luajt një bast i madh prej 52 mijë stërlinash që 29-vjeçari do të ndëshkohej me karton gjatë 10 minutave të

fundit. Pavarësisht se "topçinjtë" po fitonin ndeshjen me rezultat të thellë, Xhaka u ndëshkua në minutën e 86 të takimit me kartonin e verdhë për vonesë në ekzekutimin e një goditjeje dënimi në favor të ekipit të tij. Mesfushori zviceran me origjinë shqiptare qëndroi mbi topin për rreth 20 sekonda para se të ndëshkohej dhe menjëherë pas ndeshjes u raportua se një shumë prej 250 000 stërlinash është fituar për këtë karton të verdhë të marrë nga ai. Hetimi i Federatës Angleze përfshiu disa raste të dyshimta bastesh që u

shfaqën në fund të fitores 4-1 të Arsenalit. Sipas "Sportsmail", hetuesit kanë zbuluar prova të shumave të konsiderueshme të basteve në kriptovaluta në tregje që nuk janë të rregulluara në këtë vend, me një pjesë të madhe të aktivitetit që mendohet se ka ndodhur në Shqipëri. "Daily Mail" në artikull kujton edhe gjobën që futbollisti shqiptar mori në vitin 2018 në një ndeshje të Kupës së Botës. Teksa luante për skuadrën e Zvicrës, ai bëri simbolin e shqiponjës me duar, duke u gjobitur më pas nga FIFA.

Muja paraqitet te Royal Antwerpi

ANTWERP, 5 GUSHT - Arbnor Muja edhe zyrtarisht është futbollisti më i ri i Royal Antwerpit. Klubi belg ka njoftuar sot për transferimin e 23-vjeçarit nga Drita e Gjilanit. Muja me

Antwerpin ka nënshkruar kontratë trevjeçare, me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër. "Kosovari Arbnor Muja ka nënshkruar kontratë me RAFC. Muja (23) vjen nga

FC Drita. Tashmë e njohim mirë atë klub pas përbaljes së dyfishtë në raundin e dytë kualifikues të UEFA Europa Conference League. Arbnor Muja është një sulmues/anësor

i gjithanshëm. Kontrata është 3-vjeçare, me opsion për një sezon shtesë. Muja do të luajë me numrin 11. Mirë se erdhe, Arbnor!", thuhet në njoftimin e Royal Antwerpit.



Mane: Jam gati ta mposht Liverpoolin

MUNCHEN, 5 GUSHT - Sulmuesi i Bayern Munchenit, Sadio Mane, ka thënë se nuk do të ngurrojë nëse do ta ketë mundësinë ta eliminojë Liverpoolin nga Liga e Kampionëve këtë sezon. Mane ishte pjesë e skuadrës

“Reds” që eliminoi gjigantët gjermanë në raundin e 16 në vitin 2019, me sulmuesin senegalez që shënoi dy herë për ta eliminuar Bayernin. Pas gjashtë vjetësh të frytshme në “Anfield”, besnikëria e Manes tani është ndaj Bayernit dhe

ai është gati tani ta mposhtë Liverpoolin. “Nëse do të takohemi përsëri, sigurisht se Bayerni do ta mund Liverpoolin. Unë nuk mendoj se është e lehtë. Dua të jem më i qartë. Nëse luan për Bayernin, unë erdha këtu për

të fituar të gjitha ndeshjet e mundshme, për t’i fituar të gjithë trofetë. Sigurisht që para fillimit të sezonit objektivi ynë është të fitojmë të gjithë trofetë e mundshëm. Jam këtu për t’i ndihmuar shokët e skuadrës dhe për t’i



arritur ëndrrat tona”, ka shtuar Mane.

Lewandowski paraqitet përpara 30 mijë tifozëve: Shpresoj ta fitojmë titullin

BARCELONË, 5 GUSHT - Robert Lewandowski u paraqit zyrtarisht si lojtar i Barcelonës para 30 000 tifozëve në stadiumin “Camp Nou”, ku fjalët e para i dha në dialektin katalan: “Éstic molt content” (jam shumë i lumtur), duke shtuar: “Faleminderit shumë”. Sulmuesi polak më pas foli në anglisht, duke pranuar se është nder të jesh lojtar i Barcelonës: “Ka qenë një rrugë e gjatë, por në fund jam këtu. Jam shumë i lumtur. Jam i sigurt se do të shënoj shumë gola në këtë stadium. Pres mbështetjen tuaj”. Përpara një turme të tillë, Lewandowski pranoi se “është e pabesueshme të shohësh kaq shumë tifozë në këtë stadium. “Është shumë e veçantë për mua. Jam i sigurt se çdo ndeshje në ‘Camp Nou’ do të jetë magjike. Shpresoj të fitojmë tituj. Unë e di që tifozët do të vijnë në stadium të dielën për të na dhënë mbështetjen e tyre. Jam i sigurt se ndeshjen e fundit para fillimit të sezonit ata do të vijnë për të na brohoritur.



Është shumë e rëndësishme”, ka shtuar Lewandowski. Sulmuesi polak zbuloi gjatë prezantimit të tij te Barça se do të mbajë mbi fanellë numrin 9, atë që deri tani e ka mbajtur

Memphis Depay. Arsyeja ka të bëjë kryesisht me marketingun, sepse tifozët e Barçës, anembanë botës, janë të priirë ta blejnë pikërisht fanellën me numër 9.

Djokoviqi nuk do të luajë në ‘US Open’

NJU-JORK, 5 GUSHT - “Nuk ka asnjë shans që Novak Djokoviç të luajë në grand slam të ‘US Open’”. Është kjo deklarata e dhënë nga ish-tenisti Goran Ivaniseviç, aktualisht trajneri i serbit. Djokoviç, i pavirusuar, nuk mund të hyjë në Amerikë për shkak të ligjeve në fuqi. Për pasojë, ai nuk mund të luajë në grand slam e “US Open”, ashtu sikurse edhe në dy turnetë Masters të Montreal dhe Sinsinatit. “Novak do të bëjë gjithçka që është e mundur për të qenë në Nju-Jork. Ndoshhta e lejojnë të luajë me një leje të veçantë, por koha sa vjen e pakësohet. Personalisht nuk kam shumë shpresa që kjo gjë të ndodhë”, ka thënë Ivaniseviç. “Nuk besoj se presidenti Biden do



t’i ndryshojë rregullat edhe pse shumë prej tyre janë absurd. Nëse je pozitiv, por je i vaksinuar, mund të hysh në Amerikë. Nëse nuk je i

vaksinuar jo, edhe pse je negative. Kjo është absurde. Për fat të keq, në sport bëhet shumë politikë”, ka shtuar Ivaniseviç.

SHKURT

Marc Cucurella zyrtarizohet te Chelsea

Skuadra e Chelseas ka njoftuar edhe zyrtarisht për transferimin e Marc Cucurellas nga Brighton. 24-vjeçari me klubin nga Londra ka nënshkruar kontratë gjashtëvjeçare, e vlefshme deri më 30 qershor 2028. Cucurella te Chelsea kalon pas një sezoni mbresëlënës te Brighton, ku regjistroi 38 paraqitje dhe shënoi një gol. “Jam vërtet i lumtur. Është një mundësi e madhe për mua që t’i bashkohem një prej klubeve më të mira në botë dhe do të punoj shumë që të jem i lumtur këtu dhe ta ndihmoj skuadrën”, ka deklaruar mbrojtësi i ri i “Bluve”. Chelsea nuk ka zbuluar çmimin e paguar për shërbimet e ish-mbrojtësit të Barcelonës, por besohet se marrëveshja është mbyllur për 65 milionë euro.

Leclerc, Ferrarit: Të gjithë duhet t’i pranojmë gabimet, kështu dalim nga kriza

Piloti i Ferrarit, Charles Leclerc, asnjëherë nuk i ka fshehur defektet e tij apo të skuadrës, sidomos këtë sezon, ku “kokëkuqja” ka bërë mjaft gabime. “Jam shumë i ashpër me veten time dhe mbaj gjithnjë llogarinë e gabimeve që bëj. Dhe kur gabimin e bëj unë e jo skuadra e vuaj shumë”, ka thënë Leclerc. Më tej, në një intervistë për BBC, piloti monogask ka shtuar: “Gjithnjë dua të analizoj se çfarë nuk shkoi. Çfarë më shtyu në atë moment që të shkoja përtej limiteve dhe të bëja gabimin. Të flasësh është e lehtë, por të kuptosh është më e vështirë. Mendoj se kjo gjë më ka ndihmuar për t’u përmirësuar si pilot”. “Kjo gjë vlen edhe për skuadrën, që kur gabon duhet ta pranojmë gabimin, pasi kështu mësojmë më shpejt nga këto gabime që bëjmë. Unë nuk i mohoj gabimet, këtë gjë duhet të bëjë edhe skuadra, pasi nuk dua të humbas kohë duke u shfajësuar”, u shpreh Charles Leclerc.

Isco refuzon Romën

Francisco Alarcon “Isco” e ka refuzuar ofertën e skuadrës së Romës. Lojtari dëshiron të luajë vetëm në Ligën e Kampionëve, diçka të cilën Roma nuk mund t’ia garantojë. Lojtari përfundoi përvojën e tij me Real Madridin, pasi i skadoi kontrata, kështu është në kërkim të një skuadre të re që prej fillimit të korrikut. Për të më herët u interesua edhe Milani, por duket se interesimi i tij u zbeh pas marrjes së Charles De Keteleare.

Azpilicueta rinovon kontratën me Chelsean

Chelsea zyrtarizon rinovimin e Azpilicuetas edhe për dy sezona të tjera. Lojtari spanjoll do të vazhdojë të jetë kapiten i skuadrës angleze dhe kështu mbyll iluzionet e tifozëve të Barçës që kishin me një nënshkrim të mundshëm. Lajmin për rinovimin e kontratës së spanjollit e ka publikuar vetë klubi i Chelseas nëpërmjet një postimi në “Twitter”.

Cavani i vetofrohet Dortmundit

Edinson Cavani mund të jetë zëvendësuesi i Sebastian Heller te Borussia Dortmund. Heller u diagnostikua me një tumor në testikuj dhe do të

mungojë për disa muaj. E gjetur pa një sulmues, pasi u largua edhe Haaland (Manchester City), ekipi gjerman ka nisur të kërkojë një

lojtar me përvojë. Në skenë ka dalë 35-vjeçari Edinson Cavani, për momentin pa ekip. Sipas “Bild”, lojtari i është vetofruar Borussia, por

problem është rroga e tij e lartë, 10 milionë euro. Palët kanë nisur bisedimet për një kontratë deri në janar me lojtarin, me opsion për ta

rinovuar deri në fund të sezonit. Borussia ka kohë deri më 31 gusht për të gjetur një zëvendësues, por kjo gjë duhet bërë sa më shpejt.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM SHPLLJE PUBLIKE PËR SHITJEN E MBETJEVE METALIKE

Emri i Ndërmarrjes Shoqërore	Emërtimi i Asetit	Vendndodhja e asetit/pronës (Adresa)	Përshkrimi i asetit të luajtshëm
GJ1028 KB Agroprodukti Kamenicë	Mbetjet metalike	Zona Kadastrale Kamenicë	<ul style="list-style-type: none"> Mbetjet metalike nga serat me rezervuarin e ujit dhe ngrohësit: përfshin strukturat metalike të vendosura në afërsisht 6ha 64ari Mjetet bujqësore: Përfshin Kombajnë, Plugun, rrafshuesin, tri makina transporti, pjesë e mbetur e traktorit dhe një mini bager Hangari: Përfshin materialin metalik i çmontuar

Kushtet e përgjithshme:

- Oftohen për shitje mbetjet metalike përmes shpalljes publike si një pako ashtu "siç janë" dhe "ku janë".
- Oftat duhet të dorëzohen personalisht apo në rast që dorëzohen në emër të blerësit, pala duhet ta ketë autorizimin e noterizuar tek noteri.
- Oftat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur, në Zyrën Rajonale të Gjilanit.
- Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: emri i Nsh-së dhe emërtimi i Asetit.
- Për dorëzimin e ofertës duhet të përdoret **Formulari për Dorëzimin e Ofertës** i cili mund të merret në Zyrën Rajonale të AKP-së, apo të shkarkohet nga ueb-faqja: www.pak-ks.org
- Kriteri për përzgjedhjen e ofertuesit fitues të njësisë përkatese do të jetë çmimi i ofertës më të lartë.
- Oftat do të pranohen me **12.08.2022** prej orës 10:00 – 12:00 në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç.
- Zarfat do të hapen publikisht në Zyrën Rajonale të Gjilanit me datë **12.08.2022** në ora 12:15
- Oftat përmes faksit apo e-mailit nuk do të pranohen.
- Të dhënat e detajuara për shpalljen publike mund të merren në Zyrën e AKP-së në Gjilan, Rruga Marie Shllaku 12, Gjilan; në telefonin: +383 280 310 444 apo në email adresën: info@pak-ks.org
- Kjo shpallje përpos që do të publikohet në media në gjuhën shqipe dhe serbe në Kosovë do të publikohet edhe në ueb faqen zyrtare të AKP-së.
- Në çmimin e ofertës totale duhet të përfshihen të gjitha tatimet e aplikueshme në Kosovë, përfshirë edhe TVSH 18%, etj.
- Ne ato raste kur ekzistojnë dy oferta të njëjta, çështja rregullohet që ofertuesi i parë për nga koha ka përparësi.

Pagesa:

Oftuesi fitues është i obliguar që të paguaj shumën e ofertuar në tërësi në afatin prej 10 ditësh pas aprovimit nga ana e Bordit të Drejtorëve.

Dispozita të përgjithshme:

Shpallja publike për shitjen e mbetjeve metalike të paraqitura më lartë ofrohen për shitje "ashtu siç janë" dhe "ku janë". Oftuesit kanë përgjegjësinë të verifikojnë përshkrimin dhe kushtet e mbetjeve metalike (gjendjen faktike) dhe AKP respektivisht Autoriteti i Likuidimit i Nsh-ve përkatese do të konsiderojë se ofertuesit kanë dënuar të mjaftueshme në lidhje me mbetjet metalike të ofruara për shitje dhe nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë pengim të eventuale. Largimi i mbetjeve metalike duhet të behet në afat prej 50 ditë (kalendrike) nga dita e pagesës së çmimit të ofertuar.

Oftuesit me ndalesë ofertimi:

- Personat fizik apo juridik të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë në pronësi shoqërore, ndaj të cilëve Agjencia apo Nsh -ja ka iniciuar procedurë gjyqësore për lirim dhe pronës dhe kompensimin e dëmeve eventuale;
- Personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të paslyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) personat fizik ose juridik të cilët nuk kanë paguar gjobat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesëpadie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund).

Oftat do të pranohen me **12.08.2022** prej orës 10:00 – 12:00 në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç në:

Zyra Rajonale e AKP-së në Gjilan
Adresa: Rr. Marie Shllaku 12, 60000 Gjilan
Tel: 0280/310-444
email: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM SHPLLJE PUBLIKE PËR SHITJE TË ASETEVE TË LUAJTSHME

Emri i Ndërmarrjes Shoqërore	Emërtimi i Asetit	Vendndodhja e asetit/pronës (Adresa)	Përshkrimi i asetit të luajtshëm
PRZ007 Sharrprodhimi Dragash	70 Dele të Nsh Sharrprodhimi	Shtallat e Nsh në vendin e quajtur Mejdan- Dragash	70 dele të racës vendore nga të cilat <ul style="list-style-type: none"> 30 dele të moshës 4-6 vjeçare dhe 40 dele të moshës 7-8 vjeçare

Kushtet e përgjithshme:

- Oftohen për shitjen e 70 dele si një njësi përmes shpalljes publike si një pako ashtu "siç janë" dhe "ku janë".
- Nëse në ndërkohë pas ofertimit numri i deleve ndryshohet për arsye të ndryshme shëndetore etj, atëherë do të merret në konsideratë shuma e përgjithshme e ofertuar për 70 dele duke kalkuluar çmimin për numrin e përgjithshëm aktual të tyre.
- Oftat duhet të dorëzohen personalisht apo në rast që dorëzohen në emër të blerësit, pala duhet ta ketë autorizimin e noterizuar tek noteri.
- Oftat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në Zyrën Rajonale të Prizrenit.
- Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: emri i Nsh-së dhe emërtimi i Asetit.
- Për dorëzimin e ofertës duhet të përdoret **Formulari për Dorëzimin e Ofertës** i cili mund të merret në Zyrën Rajonale të AKP-së, apo të shkarkohet nga ueb-faqja: www.pak-ks.org
- Kriteri për përzgjedhjen e ofertuesit fitues të njësisë përkatese do të jetë çmimi i ofertës më të lartë.
- Oftat do të pranohen me **12.08.2022** prej orës 10:00 – 12:00 në zarf të mbyllur.
- Zarfat do të hapen publikisht në Zyrën Rajonale të Prizrenit me datë **12.08.2022** në ora 12:15
- Oftat përmes faksit/email-it nuk do të pranohen.
- Të dhënat e detajuara për shpalljen publike për shitjen e 70 deleve si një njësi mund të merren në Zyrën e AKP-së në Prizren, Rruga "Pushkatarët" No 9, Prizren; në telefonin: 029-226-480 apo në email adresën: info@pak-ks.org
- Kjo shpallje përpos që do të publikohet në media gjuhën shqipe dhe serbe në Kosovë do të publikohet edhe në ueb faqen zyrtare të AKP-së.
- Në çmimin e ofertës totale duhet të përfshihen të gjitha tatimet e aplikueshme në Kosovë, përfshirë edhe TVSH 18%, etj.
- Ne ato raste kur ekzistojnë dy oferta të njëjta, çështja rregullohet që ofertuesi i parë për nga koha ka përparësi.

Pagesa dhe tërheqja e aseteve:

Oftuesi fitues është i obliguar që të paguaj shumën e ofertuar në tërësi në afatin prej 10 ditësh kalendrike pas pranimit të njoftimit nga ana e AKP-së mbi aprovimin e ofertës nga ana e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Blerësi është i obliguar të bëjë tërheqjen e deleve nga prona e Nsh-së brenda 3 ditëve kalendrike nga dita e pagesës së çmimit të ofertuar.

Dispozita të përgjithshme:

Shpallja publike për shitjen e 70 deleve ofrohen si një njësi për shitje "ashtu siç janë" dhe "ku janë". Oftuesit kanë përgjegjësinë të verifikojnë përshkrimin dhe gjendjen e deleve (gjendjen faktike) dhe AKP respektivisht Autoriteti i Likuidimit i Nsh-ve përkatese do të konsiderojë se ofertuesit kanë dënuar të mjaftueshme në lidhje me delet dhe nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë ndryshim eventuale.

Oftuesit me ndalesë ofertimi:

- Personat fizik apo juridik të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë në pronësi shoqërore, ndaj të cilëve Agjencia apo Nsh -ja ka iniciuar procedurë gjyqësore për lirim dhe pronës dhe kompensimin e dëmeve eventuale;
- Personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të paslyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) personat fizik ose juridik të cilët nuk kanë paguar gjobat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesëpadie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund).

Oftat do të pranohen me **12.08.2022** prej orës 10:00 – 12:00 në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç në:

Zyra Rajonale e AKP-së në Prizren
Adresa: Rr. Pushkatarët Nr.9, (në Shatërvan) në Prizren
Tel: 029-226-480
email: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

OBAVEŠTENJE JAVNI OGLAS O PRODAJI METALNOG OTPADA

Naziv društvenog preduzeća	Naziv imovine	Lokacija (Adresa)	Opis pokretne imovine
GJ1028 ZZ Agroprodukt Kamenica	Metalni otpad	Katastarska zona i Opština Kamenica	Metalni otpad iz plastenika sa rezervoarom vode i grejačima koji uključuju: metalne strukture postavljene na površini od oko 6ha 64ara Poljoprivredna sredstva uključuju preostale delove: kombajna, pluga, tabača, tri transportne mašine, traktora i jednog mini bagera Hangar uključuje: demontirani metalni materijal

Opšti uslovi:

- Nudi se na prodaju metalni otpad preko javnog oglasa u paketu „takav kakav je“ i „tu gde je“.
- Ponude treba dostaviti lično ili ako se dostave u ime kupca, stranka treba da ima ovlašćenje notarizovano kod notara.
- Ponude treba dostaviti u zapečaćenoj kovrti, Regionalnoj kancelariji Gnjilane.
- Na kovrti (spolja) treba navesti: Naziv DP-a i Opis pokretne imovine
- Za dostavljanje ponude treba koristiti **Obrazac za dostavljanje ponude** koji se može dobiti u Regionalnoj kancelariji KAP-a, ili preuzeti sa veb stranice: www.pak-ks.org
- Kriterijumi za izbor pobjedničkog ponuđača odgovarajućih jedinica biće cena najviše ponude.
- Ponude će biti primljene dana **12.08.2022** od 10:00 – 12:00 časova u zapečaćenoj kovrti za svaku jedinicu pojedinačno.
- Kovrte će biti otvorene javno u Regionalnoj kancelariji Gnjilane dana **12.08.2022** u 12:15 časova.
- Ponude putem faks ili e-maila neće biti prihvaćene.
- Detaljni podaci o javnom oglašju mogu se dobiti u Kancelariji KAP-a u Gnjilanu, Ulica Marie Shllaku 12, Gnjilane; preko telefona: +383 280 310 444 ili imejl adrese: info@pak-ks.org
- Ovaj oglas osim što će biti objavljen u medijama na albanskom i srpskom jeziku na Kosovu biće objavljen i na zvaničnoj veb stranici KAP-a.
- Cena ukupne ponude treba da uključuje sve poreze koji se primenjuju na Kosovu, uključujući PDV 18% itd.
- U onim slučajevima kada postoje dve identične ponude, regulisano je da prioritet ima prvi ponuđač u pogledu vremena.

Uplata:

Pobjednički ponuđač je obavezan da uplati ponudeni iznos u celosti u roku od 10 dana nakon odobrenja od strane Upravnog odbora.

Opšte odredbe:

Metalni otpad naveden gore u oglašju nudi se na prodaju „takav kakav je“ i „tu gde je“. Odgovornost je ponuđača da proverie opis i uslove metalnog otpada (činjenično stanje) i KAP odnosno Likvidacioni organ odgovarajućih DP-a će smatrati da su ponuđači bili dovoljno informisani o metalnom otpadu ponudenom na prodaju i neće biti odgovorni za bilo kakvu moguću smetnju. Otklanjanje metalnog otpada treba da se izvrši u roku od 50 (kalendarskih) dana od od dana uplate ponudene cene

Ponuđači sa zabranom nadmetanja:

- Fizička ili pravna lica koja su uzurpirala nepokretnosti u društvenom vlasništvu, prema kojima je Agjencia ili DP pokrenulo sudski postupak za oslobađanje imovine i nadoknadu moguće štete;
- Fizička ili pravna lica: (i) koja nisu ispoštovala uslove određenog ugovora sklopljenog sa Agencijom ili bilo kojim preduzećem pod upravom Agencije (postojanje i priroda tog nepoštovanja biće utvrđena od strane Agencije po njenom nahođenju), (ii) fizička ili pravna lica koja nisu platila novčane kazne određene od strane Agencije ili koja se podvrgavaju određenom tužbenom zahtevu ili sporu (bez obzira da li je takvo pitanje pokrenuto u sudu ili negde drugo).

Ponude će biti primljene dana **12.08.2022** od 10:00 – 12:00 časova u zapečaćenoj kovrti za svaku jedinicu pojedinačno u:

Regionalnoj kancelariji KAP-a u Gnjilanu
Adresa: Ul. Marie Shllaku 12, 60000 Gnjilane
Tel: 0280/310-444
email: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

OBAVEŠTENJE JAVNI OGLAS ZA PRODAJU POKRETNE IMOVINE

Naziv društvenog preduzeća	Naziv imovine	Lokacija imovine (adresa)	Površina m ²
PRZ007 Sharrprodhimi Dragaš	70 Ovaca DP Sharrprodhimi Dragaš	Stala DP na mestu zvanom Mejday – Bellobrad Dragaš	70 ovaca domace rase od kojih: 30 ovaca 4-6 godište i 40 ovaca 7-8 godište

Opšti uslovi:

- Nude se u prodaju 70 ovaca kao jedna jedinica putem javnog oglasa kao jedan pako „onako kako su“ i „tu gde su“.
- Ako se u međuvremenu nakon ponude broj ovaca promeni iz raznih zdravstvenih razloga i sl., onda će se u obzir uzeti ukupan iznos ponuden za 70 ovaca, računajući cenu za njihov aktualni ukupan broj.
- Ponude se moraju predati lično ili u slučaju predaje u ime zakupca onda stranka mora imati ovlašćenje overeno kod notera.
- Ponude treba dostaviti u zapečaćenoj kovrti, dostaviti Regionalnoj kancelariji u Prizrenu.
- Na kovrti (spolja) treba navesti: naziv DP-a, naziv imovine i lokaciju imovine.
- Za dostavljanje ponude treba da se koristi **Obrazac za dostavljanje ponude** koji se može dobiti u Regionalnoj kancelariji KAP-a, ili preuzeti sa veb stranice: www.pak-ks.org
- Kriterijum za izbor pobjedničkog ponuđača za dotične jedinice biće ponuda sa najvećim iznosom.
- Ponude će biti primljene dana **12.08.2022** od 10:00 – 12:00 u zapečaćenoj kovrti.
- Kovrte će se javno otvoriti u Regionalnoj kancelariji u Prizrenu dana **12.08.2022** od 12:15 časova.
- Ponude putem faks neće biti prihvaćene.
- Detaljni podaci za javnu ponudu za prodaju 70 ovaca kao jedinice i ostale odgovarajuće informacije mogu se dobiti u Regionalnoj kancelariji KAP-a u Prizrenu, Ulica "Pushkatarët" br. 9, Prizren; preko telefona: 029-226-480 ili imejl adrese: info@pak-ks.org
- Ovaj oglas osim što će biti objavljen u dnevnom novinama na albanskom i srpskom jeziku u Republici Kosovo biće objavljen i na zvaničnoj veb stranici KAP-a.
- U cenu ukupne ponude treba uključiti sve primenljive poreze na Kosovu, uključujući i PDV 18%, itd.
- U onim slučajevima kada postoje dve iste ponude, to se reguliše tako da prvi ponuđač po vremenu, ima prednost.

Plaćanje zakupnine:

Pobjednički ponuđač je dužan da uplati ponudjenu sumu u potpunosti u roku od 10 kalendarskih dana po primljenju obaveštenja od strane KAP-a o prihvatanju ponude od strane Borda Direktora KAP-a Kupac je u obavezi da izvrši prijem ovaca od imovine DP-a u roku od 3 kalendarskih dana od dana isplate ponudjene cene.

Opšte odredbe:

Javni oglas za prodaju 70 ovaca nude se „u stanju u kakvom jesu“ i „gde su“. Odgovornost je ponuđača da ispitaju opis i stanje ovaca (činjenično stanje) i KAP odnosno Likvidacioni organ dotičnog DP-a će smatrati da su ponuđači dovoljno upoznati sa stanjem ovaca ponudjenim za prodaju i neće biti odgovorni za bilo kakvo eventualno ometanje u posedu/korišćenju.

Ponuđači sa zabranom nadmetanja:

- Fizička ili pravna lica koja su uzurpirala nepokretnu imovinu u društvenom vlasništvu, prema kojima je Agjencia ili DP pokrenulo sudski postupak za oslobađanje imovine i nadoknadu eventualne štete;
- Fizička i pravna lica koja: (I) nisu poštovala uslove bilo kakvog ugovora zaključenog sa Agencijom ili sa bilo kojim preduzećem kojim upravlja Agjencia (postojanje i priroda takvog prekršaja određuje Agjencia po sopstvenom nahođenju), (II) imaju dug ili neplaćenu novčanu kaznu prema Agenciji ili prema određenom preduzeću kojim upravlja Agjencia, (III) fizička ili pravna lica koja nisu platila novčane kazne određene od strane Agencije ili koja su predmet bilo kog tužbenog zahteva ili spora (bez obzira da li je to pitanje podneto u sudu ili u nekom drugom mestu).

Ponude će biti primljene **12.08.2022** od 10:00 – 12:00 časova u zapečaćenoj kovrti za svaku jedinicu pojedinačno u:

Regionalna Kancelarija KAP-a u Prizrenu
Adresa: Ul. Pushkatarët br.9, (kod Šadrvana) u Prizrenu
Tel: 029-226-480
email: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "GLOBAL TRADING AND CONSULTING" SHPK me seli në Prizren marrë vendim të shuajë biznesin me numër të regjistrimit: 810141911 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditor-Debitore në këtë shoqëri që të paraqesin në afat 30-ditor nga data e shpalljes.

OBAVJEŠTENJE

Obaveštavamo sve klientije da Tvrtka "GLOBAL TRADING AND CONSULTING" DOO u Prizrenu deneo odluku da ugasi biznis po br.registra: 810141911 i ujedno imenovao Likfidatora o spovodjenju postaku likfidacije. Obavještavaju se svi klienti koji imaju obazave I postravizanje u navodenoj firmi, da se javu u roku 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the company "GLOBAL TRADING AND CONSULTING" LLC in Prizren has come to the decision to quite its business with registry: 810141911. The company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All clients who have th mortgager -mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

për
shuarje të biznesit

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Nr.06/L-016, nenit 112 dhe nenit 114 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe palët tjera juridike dhe fizike se aksionari i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Strong Group SH.P.K. me numër unik identifikues: 811432971 me seli në Prishtinë, Adresa: Ismajl Dumoshi Kati II, Hyrja Nr.6-1 ka marrë vendim për shuarjen vullnetare të subjektit afarist dhe ka caktuar likuidatorin e paanshëm Nora Rahimaj me ID: 1173197388 me vendbanim në Rruga: Hasan Prishtina Nr.38 Komuna: Kamenicë me tel: 045/627-035 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të përcaktuara dhe raporte kreditore-debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Dr. Ernad Milaim Kosumi, shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë (MSH), me nr: KO-06567-01, Diploma 454 dt. 30.11.2016 Kosovë.

► Ida Cakolli shpall të pavlefshme dëftesën e kl. -X- të Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

► Arbër Hana nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Mazllom Këpuska" Gjakovë nga kl. I,V dhe VI-IX.

► Valbone Hasani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Yll Morina" Gjakovë nga kl. I-VIII.

► Albert Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. "Engjëll Gjoni" Novosell e Ulët.

► Angjelina Gojani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. "Engjëll Gjoni" Novosell e Ulët.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905